



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 28.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 26.04.2023 të parashtruar nga **OE N.N.SH VIZION PROJECT, Prishtinë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit Ideor për hartimin e projektit zbatues për Objektivin e Qendres Kulturore në Lipjan. me nr. të Prokurimit 613-23-536-2-2-3, nxjerr:**

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim OE N.N.SH VIZION PROJECT, Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit Ideor për hartimin e projektit zbatues për Objektivin e Qendres Kulturore në Lipjan. me nr. të Prokurimit 613-23-536-2-2-3,**

Vërtetohet Vendimi i AK i publikuara në platformën e prokurimit i datës: 20.04.2023, i propozuar për kontratë **Kodi 7373.**

1. Mbetet në fuqi Vendimi i AK i publikuar në Platformën e Prokurimit i datës: 20.04.2023
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Përgjigje për pretendimet e OE ankues:

Pretendimet për projektet: Fillimisht duhet të ju njoftojmë që për këtë fazë të konkursit është kërkuar Koncepti i projektit / projekti IDEOR për të zgjedhur fituesin dhe pastaj OE fitues duhet të përgatisë projektin kryesor për ndërtimin e **Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit Ideor për hartimin e projektit zbatues për Objektivin e Qendres Kulturore në Lipjan.** Komisioni i caktuar për vlerësim-juri të këtyre projekteve është përberë nga Profesioniistë të fushës përkatëse dhe vlerësimi është bërë në bazë të projekteve që janë dorëzuar nga ana e OE të ndryshme.

Kodi 7373, duhet te ju njoftojme që i njehti ka paraqitur projektin Ideor/Koncept projektin me inovativin nga të gjitha projektet ideore tjera, dhe ka paraqitur zgjidhjen më të mirë ideore, funksionale, arkitektonike dhe estetike.

Projekti në fjalë ka të paraqitur Koncept projektin/projekti Ideor arkitektnik sipas kërkeses dhe detyres projektuese, **Konkurs projektimi per zgjidhjen e projektit Ideor per hartimin e projektit zbatuese per Objektin e Qendres Kulturore ne Lipjan.** ka plotësuar kërkesat e AK me kthinat sipas detyres projektuese dhe nderlidhja e tyre me një funksion të lehtë dhe të qasëshem.

Kthinat janë me dimensione që do të thotë brenda tyre mund të nxirren edhe sipërfaqet për secilen kthinë.

Hyrjet janë të prenzatuara në baze të detyrës projektuese kurse hyrjet shpesh të paraqitura janë ide të prezantuara nga projektuesi.

Sa i përket kërkeses suaj për konstruksion dhe vlerë të projektit dhe detale tjera edhe ju si kompani projektuese e dini që këto definohen gjatë përgatitjes së projektit kryesor e jo në koncept projekt dhe projekt ideor.

Duhet të ju njoftojmë që përzgjedhja është bërë nga profesionist të fushës përkatëse dhe ky ka qenë projekti i pranueshëm dhe që është shpërblyer me piket sipas projekt ides së dorëzuar.

Sa i përket shifrave tjera 1001 dhe 1119 duhet të ju njoftojmë që kanë fituar piket në bazë të projekt ides të dorëzuara.

Ndërsa sa i përket kërkeses tuaj, për propozime ideore të OE, ju keni mundur të merrni shënime dhe dokumentacionin duke u bazuar në nenin 55, pika 55.20 të Rregullores Nr: 001/2022, Për Prokurimi Publik dhe nenin 79 të LPP-së, konkretisht paragrafi 2 i këtij ligji.


Në ju kemi ofruar qasje në ditën kur ju keni paraqitur kërkesën për qasje me datë: 24.04.2023, gjithashtu keni pasur qasje edhe më datë: 25.04.2023, nga ora 08:00 deri në ora 10:00, aq sa ka qenë e mjaftueshme për juve si OE, por nuk ju kemi ofruar projektet fizike sepse kjo është një zgjidhje që është ofruar nga i njëjti dhe e njëta në këtë fazë nuk mund të ju ipet.

Pretendimet e juaja janë të pa pabazuara lidhur me përzgjedhjen e projektit ideor për realizimin e projektit kryesor të ndërtimit të Objektit të QKMF-së dhe Urgjencës në Lipjan.

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP,
Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lartë ka vendosur si në dispozitiv.
Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Data: 28.04.2023

Bekim Shabani

Drejtor i Prokurimit



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT

Drejtoria e prokurimit Lipjan

Procesverbal për qasje në dokumentacion

I hartuar në Lipjan me date 24.04.2023

Qasje nga ora 15:00 deri 16:00

OE NNSH VISION PROJECT Shifra 1124 , ka kërkuar qasje në dokumentacion për tenderin e shpallur: Konkurs projektimi per zgjidhjen e projektit Ideor per hartimin e projektit zbatuese per Objektin e Qendres Kulturore ne Lipjan., me Nr. te prokurimit: 613-23-536-2-2-3
Përfaqësuesi nga OE NNSH VISION PROJECT Shifra 1124. ka pasë qasje në dokumentacion dhe ka kontrolluar projektet sipas kërkeses se tij.

Shkelqim Osmani

Lipjan 24.04.2023

Bekim G. Shabani

From: Bekim G. Shabani
Sent: Monday, April 24, 2023 11:21 AM
To: 'Vizion Project'
Subject: RE: KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

I nderuar!

Mund te vini sot me dt: 24.04.2023, ne ora 15:00, dhe do tu mundesohet qasja sipas dispozitave ligjore.

From: Vizion Project <info@vizionproject.com>
Sent: Monday, April 24, 2023 10:54 AM
To: Bekim G. Shabani <bekim.g.shabani@rks-gov.net>
Subject: KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

Përshendetje i nderuar,

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-215 - për Qasje në Dokumente Publike (nenin 4, pika 2 të ligjit, që thotë: Dokumentet janë të hapura për publikun në bazë të kërkesës së drejtpërdrejt, në bazë të kërkesës së bërë me shkrim ose në formë elektronike), dhe në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, (neni 10) kërkojmë që të na lejohet qasje në dokumente publike, lidhur me tenderin me titull:

Titulli: Konkurs projektimi per zgjidhjen e projektit Ideor per hartimin e projektit zbatuese per Objektin e Qendres Kulturore ne Lipjan. me numer prokurimi: 613-23-536-2-2-3 te shpallur nga

Autoriteti Kontraktues: KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN

Kërojm keto dokumente:

1. Raportin zyrtar të Vlerësimit të Koncept Projekteve për këtë aktivitet prokurimi
2. Koncept Projektin e vlerësuar me piket maksimale dhe Koncept Projektin e OE tjere pjesmarres ne kete tender.
3. Vendimin për caktimin e Komisionit Vlerësues të Koncept Projekteve
4. Deklaratat nën betim të anëtarëve të Komisionit Vlerësues të Koncept Projekteve.

Ju lutem që të na siguron qasje në këto dokumente publike më së largu deri me datë 24.04.2023, në mënyrë që të na mundësohet që në bazë të dispozitave ligjore të LPP-së të bëjmë fillimisht Kërkesë për Rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.

Ju falënderoj paraprakisht për mirëkuptim!



Shkelqim OSMANI
Director

Rr. Muhamet Gradica, Kati 1, Nr. 10,
10000 Prishtina, Kosovo
+383 (0) 45 222 888
info@vizionproject.com
www.vizionproject.com